



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 06/04/23 Ref.: 443/23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31, nenit 7 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe Manualin e Akreditimit (*përditësuar me vendimin Ref.932/22*), Këshilli Shtetëror i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në mbledhjen e 110-të, të mbajtur më 28.03.2023, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji UBT në Prizren në nivel institucional, për periudhën tre (3) vjeçare, nga 1 tetor 2023 deri më 30 shtator 2026.
- II. Obligohet Kolegji UBT në Prizren që deri më datë 15.11.2023 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT në Prizren ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1880/22 datë 31.10.2022 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT në Prizren me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 20.02.2023, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Dietmar Paier, Magdalena Platis, Marko Komso.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtarë) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji UBT në Prizren është vlerësuar se përmbushë: plotësisht dy (2), substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht katër (4) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 110 të mbajtur më 28.03.2023 ka shqyrtuar kërkesën/aplikacionin e Kolegji UBT në Prizren dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar.

Vendimi ju dërgohet :

- Kolegji UBT në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Nazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

